



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	05.08.2016
Referencë	11-344/7
Për :	Kryetar i Komunes-z. Imri Ahmeti
Përmes :	Drejtpërsëdrejti
Nga :	Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi
Lënda :	RAPORTI MUJOR-KORRIK

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Inspektime për orar të punës	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Inspektime të përbashkëta	Pelqim sanitar	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve dhe inspektim i biletave	Aktivdime- ndalesa,urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Mbyllje e përkohshme e lokalit afarist	Inspektim i kafshëve në thetore	Inspektime me polici	Inspektim i tokave bujqësore dhe korrje-shirjeve	Asgjësim i mallit	Biznese të pajisur me,pa pranime teknike,per çmime
Biznesit	574	50	11	3	15	69			78			8	52	240	1		16		7689.28€	31
Ambientit	201	46		2		3			97					35			18			
Bujqësisë	188	5				38			57					51				37		
Ndërtimtarisë	204	21							143			4	1	35						
Trafikut	414	34		5		68		5	41		98	8		61			94			
Sanitar	197	29		1	20	43			66	1				7	1	29			7689.28€	
Gjithsejtë	<u>1778</u>	<u>185</u>	<u>11</u>	<u>11</u>	<u>35</u>	<u>221</u>		<u>5</u>	<u>482</u>	<u>1</u>	<u>98</u>	<u>20</u>	<u>53</u>	<u>429</u>	<u>2</u>	<u>29</u>	<u>128</u>	<u>37</u>	<u>7689.28€</u>	<u>31</u>

Gjatë këtij muaji kemi punuar rreth identifikimit të bizneseve të pa regjistruara MTI, dhe pa pranime teknike të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjieno-sanitare, kemi kontrolluar marketet ushqimore, nëpër qytet dhe fshatra, bizneset rreth aftashmerisë së mallit, kushtet e ruajtjes së mallit, faturat e furnizimit me mall dhënien e faturave për shërbimet e ofruara konsumatorëve, çmimet e vendosura në artikuj, etj.

Në bazë të kërkesës se firmë Mc Food kemi asgjësuar mall me afat të skaduar dhe te dëmtuar në vlerë prej 7659.28 €.

Është asgjësuar një kafshë e cila ka qenë më sëmundjen gungore të lëkurës. Po ashtu në një mishtore kemi hasur mish i cili nuk ishte i vulosur dhe nuk kishte faturë për atë mall dhe e kemi asgjësuar, ku vlera e këtij malli ka qenë 720€.

Në muajin korrik është marr aksion dhe është kujdestaru së bashku me policinë në orët e mbrëmjes duke i detyruar disa kafiteri në qytet, që mos të bëjnë zhurmë për shkak të tonit të lartë të muzikës, që mos të pengohet jeta e banorëve për rreth. Janë inspektuar pishinat në lidhje me pranin e klorit në ujin e pishinës si dhe a posedojnë kontratë për mbeturina me K. Pastrimi. Janë inspektuar biznese që me veprimtarin e tyre duhet të pajisen me Leje Mjedisore nga MMPH për çfarë janë rekomanduar që të pajisen me këtë leje.

Nga inspektoret e ambientit po ashtu është dalë në teren sipas kërkesave të qytetarëve rreth problemeve me ujëra të zeza, duke i detyruar qytetarët që kyçen në rrjetin e kanalizimit, problemet me ujërat atmosferike, mbeturinave komunale, dhe shfrytëzim të hapësirë publike, për çka është dhënë vërejtje, urdhëresa, fletëparaqitje për gjykatë dhe masa tjera për mënjanimin e parregullsive.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar kompanitë e autobusëve në lidhje me rendin e udhëtimit se a janë duke e respektuar atë rendë, në relacionin Prishtinë-Lipjan-Gadime dhe anasjelltas, po ashtu është bërë inspektimi i auto-taskive në rrugët e qytetit ku janë të parkuar, se dhe në rrugën Isa Olluri, Skënderbeu dhe Lidhja e Prizrenit se mos po hasim ndonjë auto-taski që tentonë të ushtron veprimtari ilegale.

Po në këtë muaji është bërë edhe inspektimi në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë, ku kemi bërë kontrollim në lidhje me auto-taksi të cilët po tentojnë të ushtrojnë veprimtarin e auto-taksitë në mënyrë ilegale.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar proceset e korrje-shierjeve në lokacione të ndryshme të Komunës së Lipjanit bazuar mbi Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr: 03/L-040.

Janë kontrolluar disa shtëpi individuale te cilat janë pajis me leje ndërtimi.

Është duke u kontrolluar çdo pozicion i punës te të gjitha objektet shumëkatëshe, duke mos i lejuar që ta hedhin betonin ne vepër para se te kontrollohet plani i armaturës nga ana e Inspektoreve të Ndërtimit.

Është bërë inspektimi i një objekti afarist dhe banesore i cili ka filluar të ndërtohet gjatë ditëve te fundit ne rrugën “Zylfie Gashi” ku është ndërpre puna dhe janë largu nga vend punishtja punëtorët që kishin filluar gërmimin e bodrumit.

Pra në përgjithësi në muajin që e lam pas kemi bërë inspektimin e objekteve të cilat kanë filluar të ndërtohen pa leje ndërtimi dhe ato te cilat kanë leje ndërtimi dhe janë në ndërtim e sipër.

Të dhënat statistikore janë të paraqitura në tabelën e më poshtme.

